



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 13 Prot

Tiranë, më 01.02. 2010

VENDIM Nr. 47, dt. 20.01.2010

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 20.01.2010, mbasi shqyrtoi studimin " Mbi disa përmirësime dhe saktësime të Rregullores për Kriteret e ushtrimit të profesionit, veprimtarive arkeologjike dhe liçencimi",

VENDOSI:

- I. Të miratohen ndryshimet e përcaktuara në faqen 3, paragrafi 3 dhe në faqen 9, Neni 5, pika 5.2 për të shtuar kërkesat e legjislacionit për Mbrojtjen e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, të përfshira në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.
- II. Të miratojë propozimin për procedurat që do ndiqen në zonën arkeologjike "A" duke zëvendësuar në faqen 12 nënndarja 2.2, pika 2.2.1, termin "ndërtim" me "vendosje", si më poshtë vijon:

"Brënda zonës arkeologjike "A" lejohet vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal) me lartësi maksimale 3m, të cilat duhen



AGJENCIA E
SHERBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

realizuar larg mureve dhe strukturave të tjera të dallueshme apo të supozuara.”

- III. Për zonën arkeologjike “B”, përfaqësuesit e Institutit të Arkeologjisë do të paraqesin propozimet e tyre, të cilat do të shqyrtohen në mbledhjen e rradhës të KKA-së.

KRYETARI
FERDINAND XHAFERAJ

SEKRETARI I KKA
ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHERBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al